



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 2678

Prishtinë, Dt. 29/10/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Matematikë / Master në Shkencë Kompjuterike
Projektpropozimi	Përdorimi i AI në krijimin e modelit për interpretimin e gjuhës së shenjave në shqip
Kandidati	Egzon Mjeku
Mentori	Prof. Assoc. Dr. Ermir Rogova
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 30.10.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 4565

Vlerësimi i dorëshkrimit

Hyrje

Punimi i diplomës me titull "Përdorimi i AI në krijimin e modelit për interpretimin e gjuhës së shenjave në shqip" ka për qëllim të ndërtojë një model inteligjent për njohjen automatike të gjuhës së shenjave shqipe, ndërtimin e një dataseti për gjuhën e shenjave shqipe dhe të përdorë modelin LSTM për të përcaktuar saktësinë e qasjes së propozuar.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i dorëshkrimit është bërë në saje të punës origjinale, cilësisë hulumtuese, metodologjisë, analizës dhe prezantimit në dorëshkrim.

Përmbajtja e detajuar

Në kapitullin e parë, kandidati paraqet një hyrje të temës mbi inteligjencën artificiale dhe ndërlidhjen e saj me gjuhën e shenjave, duke theksuar edhe nevojën për një dataset të gjuhës së

shenjave, bazuar në faktin që një i tillë mungon për gjuhën shqipe.

Kapitulli i dytë përshkruan procesin e rishikimit të literaturës si dhe paraqet metodologjinë e kërkimit të literaturës, si dhe rekomandimet e mundshme për hulumtim.

Kapitulli i tretë diskuton specifikisht metodologjinë e hulumtimit, duke filluar nga dizajni, mbledhja e të dhënave, arkitektura e modelit, modelin dhe mjedisin e implementimit.

Kapitulli i katërt interpreton rezultatet e fituara, duke filluar prej përshkrimit teorik të metrikave të vlerësimit, rezultateve, saktësisë dhe humbjeve, dhe duke përfunduar me interpretimin e tyre.

Kapitulli i pestë u jep përgjigje pyetjeve kërkuese, të cilat ishin paraqitur në kapitullin e parë.

Kapitulli i gjashtë bën përmbledhjen e hulumtimit, duke diskutuar njëkohësisht edhe punën e së ardhmes.

Përmbledhje e të gjeturave

Punimi i diplomës Master ka një analizë të mirë dhe ka edhe shpjegim të gjerë të literaturës.


Kandidatit i janë dërguar komentet nga anëtarët e tjerë të komisionit dhe i ka inkorporuar ato në versionin final.

Konkludim


Në përgjithësi tema e diplomës Master i përmbush standardet për të fituar gradën shkencore Master. Komisioni rekomandon pranimin e temës pas disa ndryshimeve të vogla, të cilat kandidati do t'i rregullojë në ditët në vijim.

Prishtinë, 28/08/2025


Komisioni:

1. 
/ Prof. Ass. Dr. Eliot Bytyçi

– kryetar/

2. 
/ Prof. Assoc. Dr. Ermir Rogova

– anëtar/

3. 
/ Prof. Ass. Dr. Korab Rrmoku

– anëtar/